



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.11

Prishtinë, më 6.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Verica Qeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Abdyl Salihu.

Përfaqësues të ftuar: Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT, Isni Kryeziu e Imer Preteni, nga MASHT.

Përfaqësues të tjerë: Gramos Buqinca-ORCA, Agnesa Qerimi e Qendresa Ibrahimimi - KYC, Rrezarta Zhinopotoku-Behlili-GIZ, Adelina Hasani-KDI dhe përfaqësues të medias.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Teuta Haxhiu, zëvendëskryetare e parë e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.1.2018 dhe 30.1.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.1.2018 dhe 30.1.2018

Procesverbalet e mbledhjeve të datës 23.1.2018 dhe 30.1.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi, tha se ky projektligj është shqyrtuar edhe në legjislaturën e kaluar, janë mbajtur disa dëgjime publike, dhe për shkak të përfundimit të legjislaturës, nuk ka arritur të miratohet. Sipas Rregullores së Kuvendit, Projektligji për Inspektoratin e Arsimit i plotëson kushtet për shqyrtim në parim.

Shyqiri Bytyçi, tha se ky projektligj do të ketë rol kyç në sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe do të jetë bazë për të menaxhuar dhe për të përcjellë mbikëqyrjen e legjislacionit, në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë të gjitha institucionet arsimore të licencuara dhe të njohura nga MASHT, përfshirë edhe arsimin special dhe qendrat korrektuese. Ai tha se me këtë rast, sfidë për MASHT do të jetë rritja e numrit të inspektorëve të arsimit, e cila kërkon edhe rritje të buxhetit.

Ministri Bytyçi, gjithashtu tha se mbetet që me akte nënligjore të rregullohen procedurat dhe vlerësimet e performancës së mësimdhënësve në terren, ndërsa shtoi se çdo katër vite do të bëhet edhe avancimi i mësimdhënësve, gjë që do të ndikojë në rritjen e përgjegjësisë dhe angazhimit profesional, dhe për rrjedhojë, pritet të kemi ngritje të cilësisë në arsim.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se e vlerëson projektligjin, i cili sipas saj është i nevojshëm për ngritjen e cilësisë në arsim. Ajo propozoi që në procesin e inspektimit të jenë edhe nxënësit, edhe mësimdhënësit. Një propozim ka të bëjë me atë që mësimdhënësi i një shkolle të inspektojë punën e mësimdhënësit në shkollën tjetër, ku gjatë inspektimit do të shkëmbehen praktika të ndryshme nga njëri-tjetri. Propozim tjetër, si pjesë e inspektimit mund të jenë edhe nxënësit përmes anketave anonime, të cilët japin një vlerësim për punën dhe performancën e mësimdhënësit.

Teuta Haxhiu, tha se Projektligji për Inspektoratin e Arsimit është i një rëndësie të veçantë, ngase miratimi i tij do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e cilësisë në arsim. Ajo tha se numri i inspektorëve është një sfidë dhe është me rëndësi të rritet numri, si dhe të ketë inspektorë të fushës, ku përmendi edhe Komunën e Gjakovës, ku vepron vetëm një inspektor dhe është e pamundur të bëjë inspektimin adekuat. Andaj, propozoi që të rritet numri i inspektorëve të fushës, sepse pa monitorim të mësimdhënësit, nuk mund të bëhet vlerësimi i punës së mësimdhënësit.

Nezir Çoçaj, tha se projektligji i proceduar tani, shumë gjëra i ka më mirë të sqaruara, në krahasim me projektligjin e vitit 2016. Sipas tij, problematike mbetet që qeveritë nuk po i japim prioritet arsimit. Propozoi që Inspektorati i Arsimit të jetë një agjenci e pavarur, e themeluar nga Qeveria. Ai përmendi edhe disa vërejtje konkrete, që kanë të bëjnë nxjerrjen e një numri të madh të udhëzimeve administrative të parapara me këtë projektligj, që sipas tij, në të shumtën e rasteve nuk po nxirren me kohë. Çështje tjetër përmendi vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, llojet e inspektimeve, inspektimin pedagogjik, çështjen e përbërjes së komisionit të ankesave dhe çështje tjera, të cilat do t'i prezantojë gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjit.

Arbërie Nagavci, në diskutimin e saj, tha se projektligji për Inspektoratin e Arsimit është i një rëndësie të veçantë, për shkak të fushës që mbulon. Sa i përket përbajtjes së projektligjit, tha se ka vërejtje në disa nene të caktuara, që ka edhe propozime konkrete, ku përmendi fushëveprimin, funksionet e Inspektoratit të Arsimit, kriteret që duhet përmbushur për t'u punësuar në inspektorat, çështjen e angazhimit të ekspertëve të jashtëm, komisionin e ankesave etj. Në vazhdim, tha se e përkrah idenë që Inspektorati i Arsimit të jetë një agjenci e pavarur, e themeluar nga Qeveria.

Mufëra Shiniq, tha se e përkrah në parim projektligjin për Inspektoratin e Arsimit, por theksoi se nuk pajtohet me idenë që edhe nxënësit të jenë pjesë e inspektimit. Sa i përket inspektorëve të arsimit, tha se përveç që duhet të jenë të fushës së caktuar, ata duhet edhe të njohin gjuhën e komuniteteve, në shkollat ku bëhet inspektimi.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se e përkrah në parim projektligjin, për shkak të rëndësisë që ka. Ajo propozoi që në rajone të ketë inspektorë të caktuar, sipas profileve dhe pjesën më të madhe të kohës ta kalojnë në inspektime e jo në zyrë.

Fidan Rekalii, tha se e përkrah në parim projektligjin, për shkak të specifikës që ka dhe shpreson që miratimi i tij do të gjejë zbatim në praktikë.

Adem Mikullovc, kërkoi sqarim nga ministri, lidhur me çështjen e arsimit special që trajtohet nga ky projektligj. Tha se e mbështet projektligjin në parim.

Ismajl Kurteshi, tha se lidhur me këtë projektligj, komisioni do të mbajë takime dhe do të organizojë dëgjime publike me grupet e interesit, me qëllim që miratimi i tij të gjejë zbatim në praktikë. Në takimet që do t'i organizojmë, do të ftohen përfaqësues të MASHT-it, për të dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me çështje të caktuara.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, u miratua në parim, me 9 vota për dhe 1 abstenim, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, lidhur me këtë pikë, ngriti çështjen e organizimit të një tryeze pune për edukimin parashkollor dhe çështjen e vizitës së grupit punues në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Lidhur me organizimin e tryezës për edukimin parashkollor, komisioni u përcaktua për mbajtjen e saj, më datë 27.2.2018, nga ora 11:00, në Kuvendin e Kosovës, ku do të ftohen përfaqësues të MASHT, Institutit Pedagogjik, drejtorive komunale të arsimit, nga qendrat rajonale, përfaqësues të institucione parashkollore publike e private, UNICEF, GIZ, KEC, “Save the Children”, ekspertë të fushë së arsimit etj.

Ndërsa, sa i përket vizitës së grupit punues në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, kryesuesja e grupit punues, Teuta Haxhiu, u deklarua se vizita në këtë institucion do të realizohet brenda 15 ditëve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi